

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6499
E mërkurë, 29 dhjetor 2021
çmimi 0.40

Molliqaj ftohet nga policia të ofrojë fakte për rënien e dyshimtë të Bllokut A3 dhe A5 | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË TË JASHTËZAKONSHME | FAQE 4-5

OPOZITA I QUAN TË VONUARA MASAT EMERGJENTE PËR ENERGJI ELEKTRIKE



Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të martën seancë të jashtëzakonshme në të cilën është diskutuar për gjendjen në sektorin e energjisë elektrike. Deputetët e opozitës për këtë gjendje e kanë fajësuar qeverinë. Sipas tyre, masat emergjente të propozuara nga qeveria Kurti janë gjashtë muaj me vonesë

OPINION

TRE HAPAT E MUNGUAR TË QEVERISË RRETH KRIZËS ENERGETIKE | F. 5

Shkruan:
Ilir Ibrahimimi



AKTUALE



KRIZA ENERGETIKE, RAMA: S'MUND TA LËMË KOSOVËN NË TERR PËR VITIN E RI | F. 7

KOMUNA E PRISHTINËS E MERR ME PRIORITETET LIRIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE | F. 7

EKONOMI

REKORD I REMITENCAVE NË KOSOVË | F. 8

LARGOHEN NGA TREGU PUNIME NGA METALET E ÇMUARA QË U SHITËN NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN | F. 8

SPORT



ÇEKU: MBËSHTETJA PËR SPORTIN ËSHTË NË RITJE | F. 10

Turqia konfirmon përkrahjen për integrimin e Kosovës në organizatat euroatlantike | FAQE 3



SIMPTOMAT E OMICRONIT, TË NGJASHME ME GRIPIN SEZONAL | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

ShBA-ja e ndihmon Ukrainën për forcimin e kufijve me Rusinë

KIEV, 28 DHJETOR- Shtetet e Bashkuara do të financojnë projekte që do të përfshijnë edhe vendosjen e pajisjeve të vëzhgimit dhe monitorimit me qëllim që të forcohen kufijtë që Ukraina ndan me Rusinë dhe Bjellorusinë. Ky njoftim i bërë të martën nga Shërbimi Kufitar ukrainas, vjen në kohën e rritjes së tensioneve me Moskën, që ka grumbulluar mijëra trupa në afërsi të kufirit me Ukrainën.

Kievi e akuzon Moskën se grumbullimi i trupave po bëhet me qëllim që Rusia të përgatitet të kryejë ndonjë ofensivë ndaj Ukrainës. Rusia mohon se po planifikon që të kryejë ndonjë sulm dhe akuzon Ukrainën dhe ShBA-në për sjellje destabilizuese. Moska, po ashtu, po kërkon garanci të sigurisë kundër zgjerimit të NATO-s nga lindja. Sipas Shërbimit Kufitar ukrainas, ShBA-ja do të

financojë projekte në vlerë prej 20 milionë dollarësh, ku përfshihet blerja e sistemeve të regjistrimit dhe dronë, edhe pajisje të tjera mbrojtëse për rojet kufitare. Ukraina, që aspirojnë që një ditë t'i bashkohet Aleancës Veri-Atlantike (NATO), që prej vitit 2018 ka pranuar një sërë donacionesh nga ShBA-ja, përfshirë municion dhe raketa të tipit Javelin, lëvizje që janë kritikuar nga Moska.



Mbi 11 000 migrantë kanë hyrë në Gjermani përmes Bjellorusisë në 2021-n

BERLIN, 28 DHJETOR- Më shumë se 11 000 migrantë ilegalë kanë hyrë në Gjermani këtë vit përmes Polonisë nga Bjellorusia, ka njoftuar policia gjermane më 27 dhjetor. Bashkimi Evropian akuzon liderin autoritar të Bjellorusisë, Alyksandr Lukashenka, se është duke marrë migrantët nga Lindja e Mesme dhe është duke i shtyrë drejt kufijve me Poloninë dhe Letoninë e Lituaninë, në kuadër të një "sulmi hibrid" që shihet si hakmarrje ndaj sanksioneve të Perëndimit.

Shumica e migrantëve ilegalë synojnë të arrijnë në Gjermani,



vend i cili ka rritur kontrollin kufitare me Poloninë në muajt e

fundit. Policia federale e Gjermanisë ka

thënë përmes një deklaratë se ka regjistruar 11 162 hyrje ilegale "të lidhura me Bjellorusinë" këtë vit, kryesisht në periudhën gusht-nëntor.

Policia ka thënë se aktualisht është duke rënë trendi i kalimeve ilegale të kufijve, pasi në dhjetor janë regjistruar 470 raste në krahasim me mbi 8 000 në tetor dhe nëntor.

Nën ligjin gjerman, migrantët që aplikojnë për azil mund të qëndrojnë në këtë shtet derisa janë në pritje të analizimit të aplikacionit nga autoritetet.

Numri në rënie i migrantëve që kanë kaluar kufirin në dhjetor

mund të jetë reflektim i ndryshimit të politikave ndaj Bjellorusisë, pasi regjimi i Lukashenkas është goditur me paketën e pestë të sanksioneve, të cilat kanë prekur edhe shtetet e treta, me qëllim të ndaljes së valës së migrantëve.

Autoritetet bjelloruse kanë pastruar kampet e migrantëve në kufij dhe kanë transferuar më shumë se 2 000 njerëz nëpër ambiente të tjera.

Disa mijëra irakianë janë kthyer në vendin e tyre me aeroplanë, pas raportimeve se ata janë përballur me kërcënime dhe kushte të rënda nëpër kampe.

Franca ashpëron masat për luftim të pandemisë

PARIS, 28 DHJETOR - Franca ka njoftuar për kufizimet më të ashpra për luftim të pandemisë teksa shtrihet varianti Omicron i koronavirusit.

Nga 3 janari puna nga shtëpia do të jetë e detyrueshme për ata që mundin dhe organizimet publike do të kufizohen në 2 000 persona në ambientet e mbyllura.

Ky lajm vjen pasi Franca ka regjistruar më shumë se 100 000 raste të reja të infektimit të shtunën, njëherësh shifrën më të lartë të raportuar brenda një dite që prej shpërthimit të pandemisë. Megjithatë, kryeministri francez Jean Castex nuk ka marrë masa

izolimi për natën e Vitit të Ri. Shtetet në gjithë Evropën janë duke zbatuar masa të reja si pasojë e rritjes së numrit të infektiveve të nxitura nga varianti Omicron.

Disa studime kanë sugjeruar se ky variant është më i butë sesa "Delta" dhe personat e infektuar kanë më pak mundësi që të përfundojnë në spital.

Castex u ka thënë gazetarëve se pandemia duket si "film pa fund".

Ministri francez i Shëndetësisë, Olivier Veran, ka thënë se shkalla e infektimit është duke u dyfishuar çdo dy ditë, andaj ka

paralajmëruar për "mega valë" të rasteve të reja. Në masat e reja përfshihet edhe kufizimi për organizimet e jashtme me vetëm 5 000 persona si dhe ndalesa për të ngrënë ushqim nëpër mjete të transportit gjatë udhëtimeve të gjata.

Klubet e natës do të mbeten të mbyllura dhe kafiteritë do të punojnë me kapacitete të kufizuara.

Plani i këtij shteti për pasaportë të vaksinës, përmes të cilit do të kërkohet vetëm dëshmia e vaksinimit dhe jo testi negativ për të hyrë të ambiente publike, do të hyjë në fuqi më 15 janar, nëse



parlamenti francez e miraton një draft të projektligjit. Sipas të dhënave shtetërore, Franca

aktualisht ka një mesatare të raportimit të mbi 70 000 rasteve ditore me koronavirus.



Anglia nuk do të vendosë masa të reja para Vitit të Ri

LONDËR, 28 DHJETOR - Sekretari britanik i Shëndetësisë, Sajid Javid, ka theksuar se nuk do të vendosen kufizime të reja kundër koronavirusit para

Vitit të Ri. Por, ai u ka bërë thirrje qytetarëve që të vazhdojnë të jenë të kujdesshëm gjatë festimeve të fundvitit, duke

rekomanduar që të festohet në ambiente të hapura festa e Vitit të Ri, nëse një gjë e tillë është e mundshme. "Kur të hyjmë në vitin e ri, natyrisht

se do të shikojmë nëse duhen masa shtesë, por deri atëherë nuk do të ndërmerim masa të tjera", ka thënë ai.

Turqia konfirmon përkrahjen për integrimin e Kosovës në organizatat euroatlantike

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 DHJETOR- Me nderime të larta ushtarake, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka pritur të martën në vizitë zyrtare ministrin e Mbrojtjes të Turqisë, Hulusi Akar. Fillimisht, ministri Mehaj i ka shprehur mirëseardhje homologut të tij turk dhe e ka falënderuar Republikën e Turqisë për kontributin që ka dhënë deri më tani për shtetin e Kosovës. “Populli i Kosovës asnjëherë nuk e harron kontributin e Turqisë që ka dhënë në ditët tona më të vështira, por gjithashtu e falënderojmë edhe për kontributin e madh që po jep për ngritjen e kapaciteteve ushtarake”, ka thënë ministri Mehaj.

Më tej, të dy ministrat biseduan lidhur me tema të ndryshme sa i përket sigurisë dhe mbrojtjes jo vetëm në Kosovë, por në rajon dhe më gjerë, ku me këtë rast ministri Mehaj e ka falënderuar ministrin Akar për kontributin e kontingjentit të forcave turke në kuadër të KFOR-it për paqen dhe sigurinë në vend.

Në këtë takim u bisedua edhe për shkëmbim të përvojave në sferën e edukimit, trajnimit të personelit ushtarak, gjithashtu edhe për pjesëmarrje në ushtrime të përbashkëta ushtarake. Gjithashtu, u bisedua lidhur me mbështetjen e Republikën së Kosovës për integrimin në organizata euroatlantike. “Përderisa bashkëpunimi në mes të dy vendeve tona po thellohet çdo ditë e më shumë, shteti i Turqisë po bën përpjekje të



mëdha për integrimin e Kosovës në organizatat euroatlantike”, ka theksuar ministri turk i Mbrojtjes,

Hulusi Akar, duke shtuar se hapat që ka marrë Republika e Kosovës deri më tani në fushën e

diplomacisë së mbrojtjes janë shumë të rëndësishëm. Ministri Akar ka takuar edhe

presidenten Vjosa Osmani-Sadriu dhe kryeministrin Albin Kurti.

Ministri turk: Gylenistët mund të jenë kërcënim edhe për Kosovën

Ministri i Mbrojtjes së Turqisë, Hulusi Akar, ka bërë me dije se Lëvizja “Hizmet” e klerikut Fetullah Gulen mund të paraqesë kërcënim për shtetin e Kosovës. Turqia i referohet kësaj lëvizjeje me akronimin FETO dhe të njëjtën e ka shpallur organizatë terroriste. Akar ka theksuar se me palën e Kosovës kanë takime edhe për çështjen e Lëvizjes Hizmet dhe se Turqia pret “hapa konkretë” në këtë drejtim. “Kjo çështje nuk është

kërcënuese vetëm për shtetin tonë, por mund të jetë kërcënuese edhe për shtetin e Kosovës. Në këtë aspekt, nga miqtë tanë kosovarë dhe nga institucionet kosovare po presim të ndërmerren hapa konkretë”, ka deklaruar ministri turk. Në mars të vitit 2018 Kosova arrestoi dhe dëboi gjashtë shtetas turq që kishin punuar në shkollën private “Mehmet Akif” në Prishtinë.

Dëbimi i tyre është thënë se është bërë përmes një aksioni të koordinuar ndërmjet shërbimeve të inteligjencës nga Turqia dhe Kosova. Arrestimit dhe dëbimit i ka paraprirë revokimi i lejeve të tyre të qëndrimit në Kosovë. Të gjithë të arrestuarit, ndërkohë, janë përballur me procese gjyqësore në Turqi dhe në fund janë dënuar gjithsej me 56 vjet dhe 7 muaj e gjysmë burgim.

Arrestimi dhe dëbimi i tyre janë lëndë e hetimeve edhe në Prokurorinë Speciale të Kosovës, pasi dyshohet se procesi është përcjellë me dhjetëra shkelje. Ankaraja e ka shpallur terroriste lëvizjen “Hizmet” në maj të vitit 2016, duke i akuzuar mbështetësit e saj për përpjekje për ta rrëzuar qeverinë turke. Gulen ka qenë aleat i presidentit aktual të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, deri në vitin 2013.

Osmani merr ftesë për ta vizituar Katarin



PRISHTINË, 28 DHJETOR (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim ambasadorin jorezident të Katarit në Kosovë, Ali bin Hamad Al-Marri, të cilin e ka falënderuar për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Kosovës. Ambasadori Al-Marri ia ka dorëzuar presidentes Osmani ftesën zyrtare të Emirit të Katarit,

shkëlqesisë së tij Sheik Tamim Bin Hamad Al Thani, për realizimin e një vizite në këtë shtet, në një kohë të përshtatshme për të dyja palët. Presidentja Osmani ka falënderuar ambasadorin Al-Marri për ftesën dhe ka theksuar se marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve janë të shkëlqyeshme. Më tej, presidentja Osmani ka

theksuar se Kosova është e interesuar për zgjerimin e bashkëpunimit politik, ekonomik, në fushën e mbrojtjes, kulturës dhe fusha të tjera të interesit të dyanshëm. Në kontekst të këtij bashkëpunimi, Osmani ka kërkuar nga Katar i lehtësimin e regjimit të vizave për qytetarët e Kosovës.

Komuna e Prishtinës e merr me prioritetet lirimin e hapësirave publike

PRISHTINË, 28 DHJETOR (ER) - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, bashkë me zëvendëskomandantin rajonal për Komunikacion Rrugor, Sylejman Halili, kanë diskutuar për prioritetet për lirimin e hapësirave publike që kanë

për synim lehtësimin e qarkullimit të qytetarëve të Prishtinës. “Me theks të veçantë biseduam për rregullimin e trafikut, lirimin e trotuareve si dhe ndihmën e Policisë së Kosovës për lehtësimin e qarkullimit të veturave në orët e pikut, sidomos në këto ditë kur

semaforët shpeshherë nuk punojnë për shkak të mungesës së energjisë elektrike”, ka thënë Rama, duke shtuar se përmirësimi i sigurisë së qytetarëve në trafik, sidomos gjatë kësaj periudhe të festave të fundvitit, për komunën e Prishtinës është prioritet.





KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË TË JASHTËZAKONSHME

Opozita i quan të vonuara masat emergjente për energji elektrike

Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të martën seancë të jashtëzakonshme në të cilën është diskutuar për gjendjen në sektorin e energjisë elektrike. Deputetët e opozitës për këtë gjendje e kanë fajësuar qeverinë. Sipas tyre, masat emergjente të propozuara nga qeveria Kurti janë gjashtë muaj me vonesë

EPOKA ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 28 DHJETOR- Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të martën seancë të jashtëzakonshme në të cilën është diskutuar për gjendjen në sektorin e energjisë elektrike. Partitë opozitare kanë kërkuar përgjegjësi nga Qeveria e Kosovës për zgjidhjen e jo për krizën energjetike. Pas një debati të gjatë në mes të deputetëve të pozitës dhe opozitës, Kuvendi nuk ka pasur kuorum në herën e parë për t'i votuar propozimet e qeverisë. Pavarësisht prej thirrjes së ministres së Ekonomisë, Artane Rizvanolli, për ta votuar propozimin e qeverisë, në votim kanë marrë pjesë vetëm 55 deputetë. Votimi është bojkotuar nga deputetët e Listës Serbe të cilët janë në koalicion qeverisës. Sipas ministres Rizvanolli, rritja e konsumit të energjisë elektrike ka bërë që Kosova të ketë vështirësi furnizimi me

energji elektrike, sidomos në muajin dhjetor. "Një vendim i tillë i mundëson qeverisë marrjen e masave që kanë të bëjnë me vendosjen e kufizimeve në furnizim me energji për konsumatorë, ose vendosjen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë. Këto masa të vendosen për 60 ditë, mirëpo ky afat mund të vazhdohet nga deputetët e Kuvendit", ka thënë Rizvanolli. Ministria ka thënë se masat janë të përkohshme dhe kanë për qëllim ta zbutin krizën e furnizimit me energji. Masat emergjente të furnizimit me energji përfshijnë vendosjen e kufizimeve në furnizim me energji për konsumatorët dhe vendosjen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë. Me propozim të qeverisë parashihet themelimi i një Komiteti Teknik Emergjent me qëllim të identifikimit dhe paraqitjes së rekomandimeve

te Ministria e Ekonomisë. Ky komitet ka për detyrë ta rekomandojë zbatimin e masave për t'i trajtuar efektet negative të krijuara nga kriza ekonomike. Pas rekomandimeve, ministria duhet t'i publikojë masat kufizuese obligative. Vendimi parashihet masa për 60 ditë, por Kuvendi mund ta vazhdojë edhe për periudha të tjera për nga 30 ditë.

Opozita vendimin e qeverisë e vlerëson të vonuar

Deputetët e partive opozitare e kanë fajësuar Qeverinë e Kosovës për krizën energjetike. Ata kanë kërkuar përgjegjësi nga Qeveria e Kosovës për zgjidhjen e kësaj krize. Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, që udhëheq Komisionin për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, ka thënë se ky vendim i qeverisë është i vonuar. Sipas tij, do të duhej të kishte një analizë të qartë të Ligjit për Energjinë nga Qeveria e Kosovës për marrjen e këtij vendimi. "Vendimin që keni sjellë sot në Kuvend, me vetëm dy pika, po dëshironi ta

legalizoni ndërprerjen, po dëshironi ta legalizoni paligjshëm, pa logjikë ta dëmtoni konsumatorin. Ne kërkuam në seancën e kaluar që të merren masat emergjente. Kjo është paafësi direkte menaxhuese, paafësi organizative dhe ndikim politik në një ndërmarrje publike e cila e ka mbajtur barrën në situata tepër të vështira", ka thënë Shala. Kryetari i Lidhjes Demokratike e Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se qeveria nuk duhet të jetë ankuese dhe spektatore. Sipas tij, qeveria duhet të gjejë zgjidhje për tejkalimin e kësaj krize. I pari i LDK-së ka thënë se masat e qeverisë janë me gjashtë muaj vonesë, duke thënë se vendet fqinje ka disa muaj që kanë filluar të punojnë për ta zbutur krizën me energji. "Ne sot jemi në fund të dhjetorit, katër ditë pa përfunduar viti, gjashtë muaj pas fillimit të krizës. Qeveria jonë populliste siç është, verës kur të tjerët merreshin me problemet e energjisë, e kur çmimet e energjisë rriteshin gjithandej, kjo qeveri shpërndante parulla nëpër Evropë se e ka zhvillimin më të madh në Evropë, aq të lartë saqë po e arrin edhe

Kroacinë", është shprehur Abdixhiku. Kurse shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka thënë se Kosova është duke u përballur me krizën energjetike më të madhe që nga shpallja e pavarësisë. Sipas tij, kryeministri Albin Kurti, i cili nuk ishte i pranishëm në seancë, është duke e injoruar këtë problem dhe se po kërkon fajtor dhe nuk po ofron zgjidhje. Ai ka thënë se qeveria ende nuk ka ndonjë strategji konkrete për ta tejkaluar këtë krizë. "Po bëhen gati dy muaj e gjysmë që kemi ngritur alarmin te qeveria për këtë çështje, që është bërë barra më e madhe për qytetarët e Kosovës. Ky vendim është dashur të jetë në Kuvend shumë muaj më parë. Ky vendim nuk mund të ndikojë në përmirësimin e situatës me energji elektrike", ka deklaruar Tahiri. Por, ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, i ka mohuar akuzat e deputetëve opozitarë. Sipas saj, kritikën e deputetëve të partive opozitare janë kontradiktore. "Kritikat e juaja janë shumë kontradiktore. Nuk po di se në cilën të

Tre hapat e munguar të qeverisë rreth krizës energjetike



Shkruan: Ilir Ibrahim

Hapat që do të duhej të merreshin diku në gusht-shtator të këtij viti për ta kaluar më lehtë terren të cilin po e kalojmë tani, do të duhej të fokusoheshin në stabilizimin e prodhimit të brendshëm, menaxhimin e konsumit dhe sigurimin me një çmim të përbalueshëm të importit. Te tre këta hapa kërkojnë planifikim dhe analizim të mirëfilltë dhe nuk mund të bëhen ad-hoc. Ta marrim secilën nga këto

pika dhe të shohim se si do të mund të menaxhohej më mirë. Kosova operon me termocentrale të stërvjetëruara të cilat mbahen gjallë falë kontributit dhe përvojës së pashoq të punëtorëve të KEK. Këto termocentrale kërkojnë mirëmbajtje të kujdesshme dhe të vazhdueshme. Nëse këto fakte janë të ditura, atëherë menaxhmenti i KEK-ut do të duhej të siguronte që të gjitha mirëmbajtjet e nevojshme të kryhen gjatë muajve gusht, shtator, tetor, pra para fillimit të motit të ftohtë kur rritet konsumi. Gjatë këtyre muajve, ka mundur që mungesa e prodhimit nga KEK-u të mbulohej nga importi sepse edhe çmimet kanë qenë më të lira. Ndaj e blloqeve të termocentraleve tani është e

kushtueshme e këtë po besoj po e shohim të gjithë. Të gjithë jemi dëshmitarë që ministrja Rizvanolli thirrjen e parë për menaxhimin e krizës energjetike e pati për kursim. Madje këto thirrje u bënë groteske kur filloi të shpjegojë operimin e joystikave. Por ulja e konsumit nuk bëhet përmes ca thirrjeve gjysmë humoristike të cilat më tepër ngritin neveri se gatishmëri për kursim atëherë kur fillon të ndalet rryma. Por nëse diku në gusht-shtator, ministrja do ta kishte parë situatën me seriozitetin e merituar, atëherë do të kishte mundur të përgatiste një plan të mirëfilltë të uljes së konsumit, duke e bërë qytetarin dhe biznesin partner në këtë iniciativë. Koha e cila në industri njihet si peak, fillon nga ora 17 deri rreth orës 23. Nëse do të konsultoheshin

ekspertët e fushës, atëherë do të mund të bëhej një plan ku një pjesë e konsumit të kësaj kohe të bartet në orë të natës, atëherë kur konsumi bie. P.SH disa biznese prodhuese do të mund të punonin gjatë natës, kur konsumi është më i ulët apo edhe mënyra tjera të cilat do të mund të identifikoheshin nëse do të harxhohej kohë për t'i gjetur ato mundësi. Por sërish kjo kërkon një planifikim, organizim dhe menaxhim të mirëfilltë që nuk bëhet për 2-3 ditë. E treta, sigurimi i importit me çmim të volitshëm. Qeveria do të mund të ofronte garancitë e nevojshme për të siguruar sasi të energjisë për të mbuluar importin gjatë muajve të dimrit. Kosova importon çdo dimër. Sasia e nevojshme pak a shumë dihet. Sektori energjetik ka ekspertizë të

mjaftueshme, të cilët kanë mundur të sigurojnë kontrata afatgjata me çmime më të volitshme. Me sa di, madje ka pasur rekomandime të tilla por të cilat fatkeqësisht kanë hasur në vesh të shurdhur të qeverisë. Pasi që nuk është bërë një gjë e tillë atëherë, sot jemi të detyruar të blejmë energji si në pazar, pra sa të shitet sepse alternativë është lënia e qytetarëve në terr. E kuptoj dhe e mirëkuptoj ankesën e qeverisë se qeveritë e deritanishme kanë dështuar të ndërtojnë kapacitete të reja prodhuese, dhe personalisht mendoj që ky është krimi më i madh ekonomik që i është bërë qytetarëve nga klasa politike që nga paslufta e këndeje. Por ky është debat për një dimër tjetër. Këtë dimër duhet të merremi me atë se si ta zbusim terren.



KEDS-i: Sektori i energjisë po kalon një nga sfidat më të mëdha që nga paslufta

Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike (KEDS) ka njoftuar se sektori i energjisë në Kosovë është duke kaluar një nga sfidat më të mëdha që nga përfundimi i luftës. KEDS-i ka theksuar se i kuptojnë edhe protestat që u mbajtën dje para ndërtesës. "Është e drejtë e tyre dhe e respektojmë këtë. Këtë vit po përballemi me krizë

globale të rritjes së çmimeve, rritjes enorme të konsumit dhe rënies së prodhimit. Këta faktorë prekin tërë sistemin elektro-energjetik, pjesë e të cilit janë edhe konsumatorët. Ne si kompani jemi të shqetësuar për këtë. Madje për disa muaj me radhë e kemi bartur krizën në supet tona, pa u afektuar konsumatori aspak, derisa i shterëm të gjitha

resurset tona. Si kompani jemi në vitin e 9 të operimeve. Që nga fillimi i operimeve tona kemi hequr planin e reduktimeve të njohur si kategorizimi 'ABC', është thënë në njoftimin e KEDS-it. Kompania është shprehur krenare me atë që ka arritur në këtë fushë. KEDS ka bërë me dije se ka investuar gati 200 milionë euro

në sistem, duke shtuar se operimi i përgjithshëm sot është shumë më efikas. "Këto investime kanë rritur në mënyrë të prekshme kualitetin e shërbimeve për qytetarët e bizneset në të gjithë Kosovën. Kur e kujtojmë gjendjen që e trashëguam dhe pasi të merren në konsideratë të gjitha projektet e realizuara deri tani, atëherë privatizimi i KEDS-it,

s'ka si quhet ndryshe, pos një storie suksesi. Edhe këto ditë kemi bërë çdo gjë që është e mundur që të kalohet sa më lehtë kjo situatë. Kemi dhënë rekomandime dhe mbesim të gatshëm që ta luajmë rolin tonë në këto rrethana. Por, KEDS dhe KESCO janë vetëm njëri nga aktorët në sektorin e energjisë", është thënë në njoftimin për medie.

përgjigjem. Njëri thotë efektet e vendimit që i keni marrë nuk po shihen në terren e tjetri thotë se po i legjitimoni ato që veç i keni marrë. Njëri thotë ZRRE-ja po e falimenton

KEDS-in, tjetri thotë pse po i subvencioni, ndërkaq tjetri thotë shumë mirë që po i subvenciononi. Është dashur t'i subvencioni moti. Nuk po e di se nga t'ia filloj", ka thënë

ajo. Për shkak të kësaj krize energjetike, nga e mërkura e kaluar qytetarët përballen me shkurtime të energjisë elektrike.

Reduktimet u udhëzuan nga Operatori i Sistemit dhe Tregut - KOSTT për shkak të mbingarkesës në sistemin elektro-energjetik. Fatura e energjisë elektrike në

Kosovë mund të shtrenjtohet për 7 për qind në muajt e ardhshëm. Një rritje e tillë e ka kërkuar Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike (KEDS).

Kryetari i Skenderajt nis fillimin e realizimit të projekteve

SKENDERAJ, 28 DHJETOR (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka mbajtur takimin e fundit të ekzekutivit për këtë vit. Ai ka thënë se ky takim është më i

rëndësishmi pasi, sipas tij, po fillon së realizuari disa nga premtimet. "Po nisim qysh sot përgatitjet e nevojshme për fillimin e realizimit të projekteve kapitale, si:

fasadimin e objekteve banesore përgjatë sheshit 'Adem Jashari'; subqendrat në bashkësi lokale; unazat brenda zonës urbane; dhe nënkalinimin përgjatë rrugës 'Ahmet Delia'.

Kemi shumë punë për të bërë, madje edhe të merremi me borxhe të trashëguara që nuk u shihet fundi, në vend se të bëjmë luftë fjalësh", ka bërë me dije Nura.




Policia, aksion në Gjakovë, arreston 26 persona

PRISHTINË, 28 DHJETOR (ER) - Policia e Kosovës ka ndërmarrë masa ligjore ndaj 26 personave të cilët nuk kanë respektuar orën policore e ndaj disa të tjerëve që luanin bixhoz dhe që kishin armë dhe substanca narkotike. "Policia e Gjakovës ka pranuar një informatë se disa persona ndodheshin duke luajtur lojëra të fatit. Policia ka reaguar me njësitet e saj policore dhe aty ka hasur 26 persona të dyshuar të cilët ishin duke zhvilluar aktivitetin e kundërligjshëm. Gjatë bastisjes dhe kontrollit në lokacion policia ka gjetur një armë dhe një sasi të substancës

së dyshuar narkotike të llojit kanabis", ka njoftuar policia. Sipas këtij njoftimi, personat e dyshuar janë shoqëruar në Stacionin Policor në Gjakovë dhe janë intervistuar. "Bazuar në ligjin në fuqi, të gjithë të dyshuarve u është shqiptuar nga një gjobë për mosrespektimin e orës policore. Në vendngjarje ka dalë edhe një sasi e hetimeve, e cila ka bërë konfiskimin e armës, sasisë së substancës narkotike dhe të gjitha provat dhe dëshmitë për aktivitetin e kundërligjshëm të lojërave të fatit", ka njoftuar Policia e Kosovës.



Argjend Thaçi nga LDK-ja zgjedhet kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës



MALISHEVË, 28 DHJETOR (ER) - Kuvendi i komunës së Malishevës sot e ka mbajtur mbledhjen e parë të jashtëzakonshme, me rend dite, zgjedhja e kryesuesit, ku me shumicë të votave, kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës është zgjedhur Argjend Thaçi. Procesi i votimit për kryesues të

Kuvendit të Komunës ka shkuar në tri raunde, pasi në dy raundet e para asnjëri nga kandidatët nuk mori shumicën e nevojshme, ndërsa në raundin e tretë kryesues u zgjodh Argjend Thaçi nga radhët e LDK-së, i cili në këtë raund të votimit mori 15 vota, ndërsa një votë u shpall e pavlefshme. Pas kësaj, kryesuesi i ri i kuvendit

të komunës, Argjend Thaçi, ka mbajtur një fjalim rasti, ku është zotuar se do të jetë bashkëpunues me të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës së Malishevës dhe do të angazhohet për një kuvend që do të jetë në shërbim të qytetarëve dhe transparencë të plotë.

Një familje bëhet me shtëpi në Shipol të Mitrovicës

MITROVICË, 28 DHJETOR (ER) - Në prag të festave të fundvitit një familje në Shipol të Mitrovicës të martën është bërë me shtëpi të re falë ndihmës së komunës së Mitrovicës dhe kompanisë së derivateve "Petrol Company". Me këtë rast, nënkryetari i komunës, Arian Tahiri, dhe drejtori i "Petrol Company", Shkëlzen Jusaj, sot kanë dhuruar çelësat e shtëpisë së re për familjen Hajzeraj në Shipol të Mitrovicës, e cila deri më tani ka jetuar në kushte mjaft

të vështira. Kjo shtëpi është ndërtuar falë iniciativës së kompanisë së derivateve "Petrol Company", derisa komuna e Mitrovicës ka ndihmuar me material ndërtimor në vlerë prej afër 6 mijë e 300 eurosh. "I lumtur që, më në fund, ka një shtëpi për fëmijët e tij", u shpreh kryefamiljari i cili falënderoi kompaninë në fjalë si dhe komunën e Mitrovicës që u kanë mundësuar ndërtimin e shtëpisë.




Prokuroria Themelore në Gjakovë gjatë këtij viti ka zgjidhur 415 lëndë

GJAKOVË, 28 DHJETOR (ER) - Prokuroria Themelore në Gjakovë, Zyra për Ndërmjetësim, përmes procedurave alternative, duke iu referuar dispozitave ligjore të nenit 232 të KPPRK-së, gjatë

vitit 2021 ka arritur që përmes marrëveshjeve të ndërmjetësimit të zgjidhë 415 lëndë. Gjatë periudhës kohore 1 janar deri më 24 dhjetor 2021 kjo zyrë nga lëndët e pranuar

nga prokurorët e kësaj prokurorie ka zgjidhur me sukses 415 lëndë përmes marrëveshjeve të ndërmjetësimit. Prokuroria Themelore në Gjakovë, Zyra për

Ndërmjetësim, ka trajtuar të gjitha rastet me seriozitet të lartë duke vlerësuar vullnetin e lirë të palëve, barazinë e palëve, paanshmërinë dhe pavarësinë e tyre si dhe privatësinë dhe konfidencialitetin.



Simptomat e Omicronit janë të ngjashme me gripin sezonal

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 DHJETOR- Drejtori i Klinikës Infektive, Arben Vishaj, në një konferencë për medie, ka folur për variantin e koronavirusit Omicron, i cili tashmë është konfirmuar edhe në Kosovë.

Vishaj ka thënë se një nga qytetarët e infektuar me variantin Omicron ka kërkuar trajtim mjekësor në këtë klinikë dhe se gjendja e tij e përgjithshme ka qenë stabile.

Drejtori i Klinikës ka thënë se pacienti ishte i vaksinuar me dy dozat e vaksinës "Pfizer". "Ne aktualisht nuk kemi pacientë të hospitalizuar me variantin Omicron, por jemi duke i trajtuar katër pacientë të cilët janë me Covid-19 pozitiv", ka deklaruar Vishaj.

Infektologu Vishaj ka theksuar se simptomat e gripit sezonal dhe të Covid-19 janë shumë të njëjta, prandaj ka rekomanduar që të gjithë që nuk ndihen mirë të paraqiten te mjeku familjar.

Drejtori i Infektives, duke folur për procesin e vaksinimit, ka thënë se i gjithë stafi i klinikës i është përgjigjur thirrjes për ta marrë dozën përforcuese. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve që të vaksinohen, pasi është mënyra më e mirë për ta luftuar pandeminë.

Drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), Naser Ramadani, ka deklaruar se ka teste të mjaftueshme përmes të cilave detektohet varianti Omicron i koronavirusit. Sipas tij, ekipet shëndetësore po vazhdojnë të



bëjnë mbikëqyrjen e këtij varianti. "Neve na mbetet ta vazhdojmë punën për ruajtjen e shëndetit", ka thënë shkurt Ramadani.

Më 26 dhjetor Kosova ka detektuar nëntë rastet e para me variantin Omicron të koronavirusit. Testimi ishte u kryer me kit-e shtesë që kanë pranuar përmes Organizatës Botërore të Shëndetësisë. IKShPK-ja më 23 dhjetor kishte paralajmëruar se do të pajisë me këto kite, me qëllim që ta detektojnë variantin e ri Omicron.

Kosova regjistron 13 raste të reja me koronavirus

Ministria e Shëndetësisë njoftoi më 28 dhjetor se në Kosovë janë regjistruar 13 raste të reja me koronavirus. Rastet e reja dolën pas testimit të 2 628 mostrave. Sipas njoftimit, gjashtë pacientë janë shëruar në 24 orët paraprake, ndërkaq 350 janë raste aktive. Sa i përket

vaksinimit, në 24 orët paraprake janë administruar 967 doza të vaksinës. Deri më tani në Kosovë me dy doza të vaksinës janë imunizuar 780 596 persona. Të drejtë vaksinimi kanë të gjithë personat mbi 12 vjeç. Ndërkaq, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, prej 27 dhjetorit

të gjithë personat mbi 18 vjeç, që janë vaksinuar plotësisht para tre muajsh, mund ta marrin edhe dozën përforcuese. Në Kosovë përdoren dy vaksina, ajo e kompanisë "AstraZeneca" dhe vaksina kundër koronavirusit e kompanisë "Pfizer".

Molliqaj ftohet nga policia të ofrojë fakte për rënien e dyshimtë të Bllokut A3 dhe A5



PRISHTINË, 28 DHJETOR (ER)- Kryetari i PDS-së, Dardan Molliqaj, ka bërë me dije se ka marrë një ftesë nga Policia e Kosovës, gjegjësisht Departamenti për Krime dhe Korrupsion, për t'i dorëzuar dyshimet dhe pyetjet që ka ngritur në konferencën për medie në lidhje me rënien e dyshimtë të Bllokut A3 dhe A5. "Ftesë nga Policia e Kosovës. Sot

kam pranuar ftesë nga Policia e Kosovës, gjegjësisht Departamenti për Krime dhe Korrupsion, për t'i dorëzuar dyshimet dhe pyetjet që i kemi ngritur në konferencë për medie në lidhje me rënien e dyshimtë të Bllokut A3 dhe A5", ka shkruar Molliqaj në llogarinë e vet në "Facebook". Molliqaj ka ftuar të gjithë njohësit e fushës së energjisë,

secilin punëtor të KEK-ut dhe KEDS-it dhe çdo qytetar që mund të ketë informata shtesë në lidhje me këtë çështje dhe çështje të tilla, që t'i dorëzojë tek ai. "Nesër, gjatë ditës, gjetjet tona do t'i dorëzojmë në polici. Kërkesa jonë për hetim, transparencë, llogaridhënie dhe vendosje të drejtësisë, duhet të shkojë deri në fund", ka shkruar Molliqaj.

Kriza energjetike, Rama: S'mund ta lëmë Kosovën në terr për Vitin e Ri

PRISHTINË, 28 DHJETOR (ER) - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se ka kërkuar nga Ministria e Energjisë që të vlerësojë çdo mundësi ndihme për Qeverinë e Kosovës lidhur me krizën energjetike me të cilën po përballet vendi ynë. "Duke e ndjekur me shqetësim krizën e rëndë energjetike që ka prekur Kosovën, kërkoja sot

nga ministria e Energjisë të vlerësojë çdo mundësi ndihme për Qeverinë e Kosovës, që familjeve në Kosovë të mos u mungojë energjia elektrike në dy ditët e festës popullore të ndarjes së viteve!", ka shkruar Rama në llogarinë e vet në "Twitter".

Ai ka thënë se nuk mund të mos e ndajnë me Kosovën aq sa

kanë. "Shqipëria s'e ka aspak të lehtë mbrojtjen e vijueshme të familjeve e sipërmarrjeve të vogla nga dallga e tërbuar e krizës energjetike që po kërcënon çdo vend, por në sekëlldira të mëdha apo në gëzime popullore siç është Viti i Ri, ne s'mund të mos e ndajmë me Kosovën aq sa kemi!", ka shkruar Rama.



Rekord i remitencave në Kosovë

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Rrahim Selimi nga komuna e Podujevës çdo muaj pranon 500 euro nga djali i tij 34 vjeç që jeton dhe punon në shtetin e Zvicrës. Ai tregon se me paratë e dërguara e ka ndërtuar edhe shtëpinë. "Varemi nga paratë e tij. Na ndihmon shumë. Faleminderit prej tij!", thotë Selimi.

Ky 78-vjeçar, ish-punonjës i Minierës së Hajvalisë në kuadër të kompleksit metalurgjik "Trepça", thotë se pensioni në vlerë prej 182 eurosh nuk mjafton për familjen e tij prej pesë anëtarësh. Madje gjatë vitit 2021 djali i Selimit ka dërguar edhe më shumë para se zakonisht për shkak të gjendjes së krijuar me pandeminë dhe ngritjes së çmimeve.

Pikërisht viti 2021 është viti kur Kosova ka shënuar vlerën më të madhe të remitencave. Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, nga muaji janar deri në muajin tetor të këtij viti vlera e remitencave në Kosovë ka arritur në 955 milionë euro apo 160 milionë euro më shumë se vitin 2020.

Përveç remitencave, shpenzimet e jerezidentëve në Kosovë, pjesa më e madhe e të cilave janë nga diaspora, ishin në shumën prej 1.33 miliard



eurosh, e cila paraqet rritje prej 151-përqindësh në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Kjo rritje ka ndodhur pasi gjatë sezonit të verës, sipas guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, numër i madh i qytetarëve që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit pushimet i kanë kaluar në Kosovë.

Në vitin 2019 diaspora i kishte anuluar vizitat në Kosovë për

shkak të pandemisë me Covid-19. "Lehtësimi i masave kundër koronavirusit si në Kosovë dhe jashtë saj bëri që viti 2021 të jetë një vit i suksesshëm, duke pasur parasysh ardhjen masive të diasporës gjatë verës. Edhe politikat mbështetëse të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës bënë që viti 2021, sipas vlerësimeve tona, të ketë një rritje ekonomike prej 9.9-përqindësh", ka thënë Mehmeti javën e kaluar në konferencën përmbyllëse për këtë fundvit.

Edhe profesori i Ekonomisë, Mejd Bektashi, thotë se vizitat më të shpeshta të mërgimtarëve kanë ndikuar në rritjen e remitencave. Të hyrat nga diaspora, thotë ai, kanë efekte mbi mirëqenien e qytetarëve. Në shumicën e rasteve, sipas tij, këto mjete kanë mbuluar financimin e konsumit të familjeve për nevojat elementare. "As buxheti dhe as ekonomia e Kosovës nuk do të mund të funksiononin në mënyrë

normale po të mos ishin remitencat aq të larta. Po të mos ishin remitencat, do të kishim krizë më të thellë në nivelin ekonomik dhe social", thotë Bektashi.

Edhe Rrahim Selimi thotë se gjendja e familjes së tij do të ishte e papërbalueshme pa paratë që sjell djali nga Zvicra. "Gjithçka e blerë, ushqimi, rryma, uji, mbeturina. Nuk di si do ta kalonim muajin pa paratë e djalit", thotë ai.

Megjithatë, Bektashi e konsideron të nevojshëm ndryshimin e orientimit të remitencave nga konsumi në investime. "Unë jam ithtar i asaj që qeveria të krijojë kushte të favorshme, të krijojë lehtësira në formë fiskale apo forma të tjera për t'i joshur mërgimtarët për të investuar në prodhim në mënyrë që ata të bartin kapitalin, dijen dhe përvojën në vend, njëherësh të ketë hapje të vendeve të reja të punës", thekson Bektashi.

Numri i qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, deri në fund të vitit 2018 vlerësohet të jetë më shumë se 850 mijë banorë.

Numër i madh i tyre jetojnë në Gjermani, Zvicër, Austri, por edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Largohen nga tregu punime nga metalet e çmuara që u shitën në kundërshtim me ligjin

PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Inspektorati i Tregut në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) gjatë muajit dhjetor ka inspektuar disa operatorë ekonomikë të cilët merren me tregtinë e punimeve nga metalet e çmuara, ari dhe argjend. Me këtë rast Inspektorati i Tregut i MINT ka larguar nga tregu një numër të konsiderueshëm të punimeve nga metalet e çmuara të cilat janë vendosur në treg për konsumatorë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-154 për Punimet nga Metalet e Çmuara.


Operatorët ekonomikë para vendosjes në treg të punimeve nga metalet e çmuara kanë për obligim që punimet t'i kontrollojnë dhe të shënojnë me shenjën e harmonizimit (e cila vërteton saktësinë e pastërtisë së punimit nga metali i çmuar). Shenja e harmonizimit vendoset në Laboratorin e Punimeve nga Metalet e Çmuara në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës/MINT.

Inspektorati i Tregut ka njoftuar se do t'i vazhdojë inspektimet në bashkëpunim me Doganën e

Republikës së Kosovës, derisa të sigurohemi që të gjithë operatorët ekonomikë të cilët merren me tregtimin e punimeve nga metalet e çmuara janë duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi. "Në të njëjtën kohë u bëjmë thirrje konsumatorëve që gjatë blerjes së punimeve nga metalet e çmuara (ari dhe argjendi), të kërkojnë nga operatori ekonomik të dëshmojë që punimet janë të shënuara me shenjën e harmonizimit. Në rast se punimi nga metali i çmuar nuk është i shënuar, lutën konsumatorët t'i refuzojnë blerjet dhe ta njoftojnë Inspektoratin e Tregut në MINT. Inspektorati i Tregut ka iniciuar kërkesat për fillimin e procedurës kundërvajtëse pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë për operatorët ekonomikë dhe pritet që këto lëndë të trajtohen konform dispozitave ligjore në fuqi. MINT dhe Inspektorati i Tregut janë të përkushtuar përherë për mbrojtjen e konsumatorëve dhe konkurrencës së drejtë në treg", ka njoftuar Inspektorati i Tregut në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.



A është e dënuar të zhduket specia njerëzore?



Po. Raca njerëzore është e destinuar të zhduket një ditë. Sado e trishtë që mund të tingëllojë kjo, kështu do të shkojnë gjërat, çfarëdo që të bëjmë ne. Dhe këtë na e tregon edhe historia: shumica dërrmuese e specieve të gjalla që kanë banuar në planetin tonë – mbi 99.9 për qind e tyre – janë zhdukur.

Pasi ta kemi pranuar këtë me qetësi, mund të kalojmë në pyetjen tjetër: Kur do të zhdukemi? Këtu gjërat bëhen interesante, dhe hyjmë në fushën e përgjigjeve më pak të qarta. Çështja është shumë komplekse, pasi faktorët dhe variablat e përfshirë janë të shumtë dhe të lidhur me njëri-tjetrin, në një mënyrë që nuk është lehtësisht e kuptueshme, dhe të paktën pjesërisht e paparashikueshme.

Për t'u orientuar, hapi i parë i komunitetit shkencor është sërish duke parë se çfarë ka ndodhur me speciet e tjera. Për shembull, paleontologu dhe biologu evolucionar Nikolas R. Longriç e përmbledhi këtë në një ese të botuar në "The Conversation". Cilat janë tiparet e specieve tona? Çfarë na bën më të prekshëm, apo më rezistencë se të tjerët?

Gjaknxehtë dhe gjakftohtë

Sipas Longriç një element i rëndësishëm, lidhet me të qenien si specie të mëdha dhe

me gjak të ngrohtë. Kafshët me gjak të ftohtë mund të mbijetojnë për muaj me radhë pa ushqim. Më të mëdhenjtë, si njerëzit apo dinozaurët, kanë zakonisht një metabolizëm më të shpejtë. Për rrjedhojë kanë nevojë për sasi të mëdha ushqimi që duhen konsumuar vazhdimisht, gjë që i bën ata veçanërisht të ndjeshëm edhe ndaj ndërprerjeve të shkurtra në zinxhirin ushqimor.

Jetëgjatësia dhe ngadalësia riprodhuese

Një faktor tjetër, lidhet me jetëgjatësinë e specieve sonë dhe mundësinë për të pasur vetëm një pasardhës në të njëjtën kohë (përveç lindjes së binjakëve, që në çdo rast janë ngjarje të rralla). Një riprodhim i tillë i ngadalë, e bën më të vështirë rikuperimin pas një rënije të mundshme demografike, dhe mbi të gjitha i jep fund përzgjedhjes natyrore. Kjo do të thotë se speciet tona, nuk janë veçanërisht të shpejta në përshtatjen ndaj ndryshimeve mjedisore. Henri Gi, biolog evolucionar që është marrë shumë me këtë temë, thotë se popullsia njerëzore është rritur shumë shpejt dhe rezultati i këtij bumi demografik, është një ndryshueshmëri e vogël gjenetike midis individëve.

"Ka më shumë ndryshueshmëri gjenetike tek

disa bashkësi shimpanzesh, sesa në të gjithë popullatën njerëzore. Dhe kjo mungesë e ndryshueshmërisë gjenetike, nuk është asnjëherë mirë për mbijetesën e një specije"- thekson ai.

Jemi të shumtë në numër (të paktën tani për tani)

Sipas vlerësimeve më të fundit të OKB-së, popullsia e Tokës do të arrijë në 11 miliardë njerëz deri në fund të këtij shekulli. Biomasa jonë e tejkalon atë të gjithë gjitarëve të egër. Edhe nëse një luftë pandemike apo termonukleare do të eliminonte 99 për qind të popullsisë së tokës, miliona njerëz do të mbijetonin, një numër ky i mjaftueshëm për ta ripërtërirë specien tonë.

Por sa të besueshme janë këto shifra? Sa do të zgjasë rritja e popullsisë? Gi argumenton se në kundërshtim me vlerësimet e shumta, popullsia globale mund të nisë të bjerë së shpejti, për shkak të një përzjerje faktorësh ekonomike (produktiviteti ka ngecur prej rreth 20 vjetësh, burimet natyrore nuk janë të pafundme), sociale (gratë prirjen të shtyjnë gjithnjë e më vonë momentin e lindjes së fëmijëve) dhe kujdesit shëndetësor (i ashtuquajturit spermokalips, pra rënia progresive e pjellorisë mashkullore për shkak të ndotjes, ushqyerjes së dobët

dhe stilit sedentar të jetesës. Këto të dhëna - thotë shkencëtari - tregojnë se "njerëzimi po shkon drejt zhdukjes".

Ne jemi kudo, dhe jemi "gjeneralistë"

Fatmirësisht ka ende diçka që funksionon në favorin tonë. Për shembull, fakti që ne jemi praktikisht të kudondodhur në Tokë. "Organizmat e shpërndarë mirë gjenetiksht, janë më të afta të përballojnë fatkeqësitë. Një përhapje e madhe gjeografike, do të thotë të mos i kesh të gjitha vezët në një shportë. Nëse shkatërrohet një habitat, speciet mund të mbijetojnë në një habitat tjetër"- shkruan Longriç. E njëjta gjë vlen edhe për dietën tonë ushqimore. Fakti që ne nuk varem nga një burim i vetëm ushqimor, mund të na ndihmojë që të mos zhdukemi kaq shpejt. Në varësi të disponueshmërisë së ushqimit, ne mund të jemi barngrënës, peshkngrënës, mishngrënës, dhe gjithçkangrënës.

Ne kemi "kulturën e përshtatjes"

Megjithatë, faktori më i rëndësishëm është një tjetër, dhe ai ka të bëjë me atë që Longriç e quan aftësia jonë për t'u përshtatur nëpërmjet evolucionit kulturor. Është e


vërtetë, që nga pikëpamja gjenetike jemi shumë të ngadalë në evoluim. Por kjo ngadalësi kompensohet nga një shpejtësi ekstreme të evolucionit kulturor.

"Balenave iu deshën miliona vjet për të evoluar hidrolikatorin, pendët dhe dhëmbët; ndërsa neve vetëm disa mijëvjeçarë për të ndërtuar varka. Ndërkohë, evolucionin ynë e kulturor tejkalon edhe atë të viruseve. Gjenet virale evoluojnë brenda pak ditësh, ndërsa njerëzve u duhen vetëm disa sekonda për të larë duart"- thotë Longriç.

Çfarë duhet të presim

Ne kemi qenë në "kreshtën e dallgës" për më shumë se 250.000 vjet. Nga sa kemi parë, mund të mbetemi atje për një kohë të gjatë. Por ndoshta, në këtë pikë, do të ishte e përshtatshme t'i bënim vetes një pyetje tjetër: Si duam të mbijetojmë? A na mjafton thjesht mbijetesën, apo duam diçka më shumë?

A ndihemi gjithsesi mirë me idenë e të jetuarit në një mjedis armiqësor, post-apokaliptik, ndoshta duke u zhvendosur në tokë, për t'i shpëtuar rrezatimit të një lufte bërthamore, apo për t'u strehuar nga një klimë gjithnjë e më e keqe? Duhet të mendojmë seriozisht mbi këto, para se të jetë tepër vonë. / Wired - Bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Çeku: Mbështetja për sportin është në rritje



PRISHTINË, 28 DHJETOR - Mbështetja gjithnjë është në rritje për sportin ka bërë me dije ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku. Sipas tij, janë shtuar 455 mijë euro për federatat sportive, kurse mbështetja e përgjithshme është 6.35 milionë euro. "Rreth 455 mijë euro është shuma shtesë që kemi siguruar javën e kaluar për federatat e sportit. Mbështetja e përgjithshme për Komitetin Olimpik, federatat, klubet dhe sportistët gjatë vitit 2021 është 6,35 milionë euro, një rritje prej 57 për qindësh krahasuar me vitin 2020 dhe 51 për qind krahasuar

me vitin 2019", ka thënë ministri Çeku. Sipas tij, brenda programit të ringjalljes sporti dhe sportistët kanë përfituar 2.28 milionë euro: 27 federata (dhe KOK e KPOK), 214 klube sportive (dhe organizata), 178 sportistë. Mbështetja e përgjithshme për federatat e sportit gjatë vitit 2021 është mbi 4 milionë euro, një rritje prej 115 për qindësh krahasuar me vitin 2020 dhe 60 për qind krahasuar me vitin 2019. "Siç e kemi shpallur nga fillimi, sporti është prioritet nacional i qeverisë. Viti i ardhshëm, ndër të tjera, do të na gjejë me: Strategjinë dhe Planin e

Veprimet për Zhvillimin e Sportit; Programin afatgjatë për funksionalizimin e ligave sportive në të gjitha shkollat e vendit; Përfundimin e disa projekteve të trashëguara dhe nisjen e të rejeve në infrastrukturë sportive; Programin për brandimin ndërkombëtar të Kosovës si 'Shteti i Xhudos'; Formulën e re të financimit të klubeve sportive nga shteti (përfshi trajnerët sportiv); Politikën e re të kategorizimit, vendosjen e rregullsisë financiare dhe rilicensimin e federatave të sportit", ka deklaruar ministri Çeku.

SHKURT

Skitari Drin Kokaj regjistron rezultatin më të mirë në karrierën e tij

Drin Kokaj ka shënuar rezultatin më të mirë në karrierën e tij në garat e Federatës Ndërkombëtare të Skitarisë (FIS). Skitari i Kosovës, shpresë Olimpikë 2022, përmbushi një nga pesë kriteret e nevojshme për normë olimpikë për Lojërat Olimpikë Dimërore "Pekini 2022", disiplina e slallomit. 18-vjeçari arriti 151.19 pikë në garën e sotme, të mbajtur në Kollashin të Malit të Zi, derisa u rendit i nënti nga 27 garues, 11 prej të cilëve nuk e përfunduan njëjërën nga dy garat. Rezultati i tij ishte 1 minutë e 39.03 sekonda.

Faqja zyrtare e Napolit shkruan për çmimin e Rrahmanit në Kosovë

Pak ditë më parë mbrojtësi Amir Rrahmani u shpall lojtari më i mirë i Kosovës për vitin 2021. Për këtë çmim të vlefshëm i është gëzuar skuadra e tij, Napoli, teksa ka shkruar disa fjalë për yllin e tyre. "Amir Rrahmani është shpallur lojtari më i mirë i Kosovës për vitin 2021. Mbrojtësit të Napolit iu dha çmimi nga Shoqata e Futbollistëve të Kosovës në evenimentin vjetor të Laureatëve të Vitit. Rrahmani ka shënuar tri gola që kur iu bashkua Napolit në verën e vitit 2020", shkruhet në postimin e klubit në "Twitter". Ylli i Kosovës është duke kaluar nëpër një formë të shkëlqyeshme me skuadrën e Napolit, duke zënë vend në formacionin e trajnerit, Spalleti. Kapiteni i Kosovës, gjithashtu, arriti të hyjë në formacionin e javës së 18-të në Serinë A, pas paraqitjes së shkëlqyeshme ndaj Milanit, ku u vlerësua me notën 7.7.

Ferran Torres është futbollisti më i ri i Barçës

Barcelona e ka zyrtarizuar afrimin e Ferran Torres nga Manchester City. Mediet iberike kanë zbuluar edhe detajet e lëvizjes teksa, sipas tyre, operacioni mund ta arrijë shifrën e 65 milionë eurove, të ndara në këste. Pavarësisht prej borxheve të mëdha, ekipi blaugran ka mundësi të bëjë lëvizje të tilla në merkato. Kujtojmë që City e transferoi për 23 milionë euro, plus 12 në formë bonusesh. Torres i ofron Xavit shumë opsione në fazën sulmuese, pasi mund të luajë si në krahë ashtu edhe në qendër të sulmit. Klauzola e lirimt nga Barcelona është plot 1 miliard euro, një shifër që me siguri nuk do të paguhet nga asnjë skuadër.

Emir Sahiti i bashkohet Kosovës

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Futbollisti i Hajdukut të Splitit, Emir Sahiti, ka vendosur që t'i bashkohet Kombëtares së Kosovës. Ai, pas takimit të sotëm me presidentin Agim Ademi, e ka nënshkruar shkresën nëpërmjet së cilës do t'i kompletohet dokumentacioni i nevojshëm për t'u paraqitur në fanellën e "dardanëve". Sahiti është sulmues anësor dhe aktualisht është duke kaluar formë shumë të mirë në

kampionatin kroat. Në këtë edicion ai ka luajtur në 18 ndeshje me Hajdukun, duke qenë ndër lojtarët më të mirë të skuadrës, teksa ka kontribuar me 2 gola dhe 2 asistime. Emir Sahiti në të kaluarën ka luajtur për ekipin kombëtar të Shpresave të Shqipërisë, kurse tani dëshira e tij është ta përfaqësojë Kosovën. Presidenti Ademi e përgëzoi Emir Sahitin për vendimin e marrë dhe i shprehu

mirëseardhje në kampin e "dardanëve", me shpresë që viti 2022 do të jetë vit i sukseseve të përbashkëta. Ndërkaq Emir Sahiti u shpreh i lumtur që po i jepet mundësia që ta japë kontributin e tij për kombëtaren e Kosovës, teksa theksoi se do të vazhdojë të punojë me përkushtim dhe ta japë maksimumin si në fanellën e klubit të tij, në të ardhmen edhe në fanellën e "dardanëve".



Ronaldinho: Mbappe tashmë është tek ekipi më i mirë në botë

PARIS, 28 DHJETOR - Ish-futbollisti i PSG-së dhe Brazilit, Ronaldinho, ka folur për klubin parisien PSG-në si dhe ka komentuar situatën e Kylian Mbappes. Mbappe është lidhur vazhdimisht për një kalim te

skudra e Real Madridit dhe për këtë situatë ka folur Ronaldinho i cili beson se do të jetë aty për një kohë të gjatë. "Të gjithë lojtarët në botë duan të luajnë në PSG. Më të mirët në botë janë te PSG-ja. Pra,

është klubi më i mirë në botë. Mendoj se [Mbappe] është këtu për një kohë të gjatë. PSG-ja është standardi botëror. Do të ishte fantastike për karrierën e Mbappes të fitonte Ligën e Kampioneve. Ai është shumë i

ri dhe tashmë ka arritur shumë. Mendoj se atij i mungon Liga e Kampioneve. Do të ishte mirë nëse do të fitonte me PSG-në. Të gjithë imagjinojnë se kanë një shans për ta fituar Ligën e Kampioneve, sepse ata kanë



një grup [korrespondues] lojtarësh", ka thënë Ronaldinho në kanalën e PSG-së në "YouTube".

Konfirmohen organizatorët e Kampionateve Evropiane, U16 mbahet në Prishtinë

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Mikpritësit për Kampionatin Evropian të FIBA-s për Shtetet e Vogla dhe Kampionatet Evropiane të të Rinjve 2022 janë shpallur pasi janë miratuar nga Bordi i FIBA Europe në fillim të këtij muaji, me përcaktimet e hershme për ngjarjet e vitit 2023 të konfirmuara gjithashtu, derisa janë njoftuar edhe federatat përkatëse për zhvillimin e këtyre garave, ndër to edhe Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK).

Kampionati Evropian për Shtetet e Vogla në konkurrencën e femrave për Përfaqësuesen A do të mbahet në Nikozia të Qipros prej 28 qershorit deri më 3 korrik 2022. Në këtë ngjarje do të marrë pjesë edhe Kosova A e femrave, ku këtë vit debutoi në garat ndërkombëtare, duke u renditur në vendin e tretë. Po ashtu, është vendosur edhe për gjeneratat e reja. Në Prishtinë do të




organizohet FIBA U16 European Championship, Divizioni C nga 7 deri më 22 korrik. Kosova edhe në vitin 2019 ishte organizatore, ku "Dardanët" e rinj triumfuan në fund. Kosova U20 te femrat do të marrë pjesë në FIBA European Championship, Divizioni B, që mbahet në Shkup të Maqedonisë Veriore, nga 9 deri më 17 korrik

2022. U20 te meshkujt do të marrë pjesë në Tbilisi të Gjeorgjisë nga 15 deri më 24 korrik, në FIBA European Championship, Divizioni B. U18 te meshkujt do të marrë pjesë po në FIBA European Championship, Divizioni B, që zhvillohet nga 29 korriku deri më 7 gusht në Oradea të Rumanisë.

Shtohen rastet me Covid në NBA, pezullimi i sezonit nuk është alternativë

WASHINGTON, 28 DHJETOR - Edhe pse rastet me koronavirus janë shtuar ndjeshëm në NBA (aktualisht janë mbi 110 lojtarë në karantinë), sezoni nuk do të ndalet. Komisionari i NBA-së, Adam Silver, ka folur për situatën, duke pranuar se për momentin pezullimi i sezonit nuk është alternativë. "Tani për tani ky plan për ta ndaluar kampionatin nuk është në tryezë dhe do të vazhdojmë normalisht me ndeshjet. Ne i kemi ekzaminuar të gjitha alternativat dhe nuk e kemi marrë në konsideratë ndaljen e sezonit në këtë moment", ka thënë Adam Silver. "Mendojmë se përgjegjësia është më e lartë për të vazhduar, pasi sporti është i



rëndësishëm për shoqërinë tonë. Ndaj po punojmë për të gjetur mundësitë e duhura për ta vijuar sezonin normalisht. Ky virus nuk do të ndalet, ndaj duhet të mësohemi të bashkëjetojmë me të", u shpreh Silver. "Vaksina nuk do të jetë e detyrueshme, pasi në

NBA janë vaksinuar 97 % e lojtarëve dhe 65 % e tyre ka marrë edhe dozën e tretë. Ne po marrim masa të ndryshme për t'i lehtësuar skuadrat", ka deklaruar Silver, që konfirmoi se aktualisht 90 % e rasteve me Covid-19 në NBA janë me variantin "Omicron".

SHKURT

Lewandowski: Jam i lumtur në Bayern

Sulmuesi i Bayern Munchenit, Robert Lewandowski, ka bërë me dije se është i lumtur në skuadrën gjermane dhe se nuk po mendon të largohet. "Në jetën time futbollistike kam bërë gjithmonë atë që kam zgjedhur. Mund të luaj edhe për shumë vjet. Nuk kam menduar për të ardhmen e pas disa vjetëve. Ndoshta mund ta bëj, por për momentin gjërat po shkojnë mirë, jam i përqendruar në sezonin aktual si dhe për ndeshjet e ardhshme. Çdo vit ka zëra. Për mua nuk ka asgjë të re. Jam i përqendruar në fushë dhe në stërvitje. Është e vështirë që të dëgjosh kaq shumë zëra, por e rëndësishme është që të jesh i lumtur aty ku je", ka thënë Lewandowski.

Mick Schumacher: Dua titullin, në të kundërtën nuk garoj në Formula 1

"Ëndrra ime është ajo që të dueloj për titullin kampion bote në Formula 1. Mundësisht në sezonin tjetër. Ndoshta nuk duket real si objektiv duke parë rezultatet e këtij sezoni, por nëse nuk do të dëshiroja këtë gjë, atëherë nuk do të isha në Formula 1". Ka qenë ky komenti që ka dhënë Mick Schumacher, piloti 23-vjeçar i Haas, djali i shtatë herë kampionit të botës, Michael Schumacher. Piloti i ri gjerman debutoi këtë vit në Formula 1 me Haas, makinë me të cilën do të garojë edhe vitin tjetër, ndërkohë që do të jetë edhe pilot rezervë i Ferrarit. "Shpresoj që sezonin e ri të jemi më shpesh në zonën e pikëve dhe ky është objektiv për vitin tjetër. Të shohim nëse do ta arrijmë këtë objektiv që në garën e parë", ka deklaruar Mick Schumacher.

Edhe Alba infektohet me Covid

Një tjetër rast pozitiv me Covid-19 është lajmëruar te skuadra e Barcelonës. Barcelona mbrëmë njoftoi për dy raste pozitive me Covid-19, por numri sot është në rritje e sipër. Pas Clement Lenglet dhe Dani Alves, një tjetër mbrojtës i skuadrës, ka rezultuar pozitiv. Bëhet fjalë për mbrojtësin e majtë, Jordi Alba. Spanjoli ka rezultuar pozitiv në testet e bëra të martën. Lojtari është në gjendje të mirë shëndetësore, por i izoluar.

De Ligt, afër largimit nga Juventusit

E ardhmja e Matthijs de Ligt mund të jetë larg Juventusit. Këtë e ka paralajmëruar edhe menaxheri i futbollistit holandez, Mino Raiola. "Është koha për hapin e ri", ka thënë menaxheri italian, teksa ka folur për të ardhmen e ish-futbollistit të Ajaxit. Qendërmbrojtësi nuk ka shkëlqyer sa është pritur nga ai në Torino. Prandaj largimi i tij në fund të këtij sezoni është i mundshëm. Në të kaluarën interesim për 22-vjeçarin kishte shfaqur Barcelona, e cila e sheh atë si pasardhës të Gerard Piques. Mbetet të shihet se cila do të jetë e ardhmja e përfaqësuesit holandez. Natyrisht, Juve e konsideron atë të rëndësishëm dhe do ta shiste vetëm për një ofertë të pafuzueshme.

Insigne në fund të sezonit largohet nga Napoli, shkon në Toronto

Lorenzo Insigne i ka ditët e numëruara te Napoli. Kapiteni ka vendosur të mos rinovojë kontratën dhe do të largohet në fund të sezonit.

Megjithatë, ajo që surprizon është destinacioni i ardhshëm i sulmuesit. Sipas gazetës napolitane "Roma", 30-vjeçari do të transferohet

në Kanada te skuadra e Torontos. E përditshmja bën me dije se klubi i ka ofruar një kontratë pesëvjeçare ku do të përfitojë me 9.5

milione euro në sezon. Insigne do të qëndrojë deri në fund të sezonit te Napoli, më pas do të zhvendoset në kontinentin tjetër për të

nisur një aventurë të re. Italiani kërkohej me ngulm nga Interi, por edhe skuadra të tjera prestigjioze në Evropë.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Hamdi Mustafa, nga fshati Ticë, komuna Skenderaj, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së IX- shkolla fillore "Ismet Uka" Ticë.

► Elizabeta Sabri Islami shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të parë dhe të dytë të shkollës së mesme Ekonomike drejtimi Juridik Prishtinë.

► Liridon Rexhaj shpall te pavlefshme dëftesën e kl II dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Votin Kolukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX SHFMU "Heronjtë e Lumes" Vermicë.

► Dyze Daqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Shtjefen Gjeqovi" Zym.

► Ilami Susuri shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Dëshmorët e Zhurit" Zhur.

► Mert Artan shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX SHFMU "Emin Duraku" Prizren.

► Arian Bobaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX SHFMU "Dëshmorët e Kabashit" Korishë.

► Uran Shala shpall te pavlefshme certifikatën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

